



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 12, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës dhe konform nenin 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-51839, të datës 30.08.2024

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi, 01-Nr-016-51839 i datës 30.08.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, banesat e Komunës, sipas vendimit paraprak 01-Nr-016-29991, të datës 30.05.2024 të miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Neni 2

Pika 2.3, e Nenit 2, të vendimit bazike ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

z/znj.-----Përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës, emërohet anëtare e komisionit të lartcekur, pasi që **Besa KUQI** ka dhënë dorëheqje të pa revokueshme.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera komplete të vendimit bazë me numër 01-Nr-016-51839, të datës 30.08.2024, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI